



Procedurat gjatë realizimit të orës

Hapi i parë: Hyrje

Futni qëllimet për orën dhe qëllimet për nxënësit nga **plani për orë mësimore**. Ndajeni **materialin nr. 1 – Udhëzues për diskutim të argumentuar** dhe diskutoni lidhur me të. Shqyrtoni rregullat për diskutim të argumentuar dhe ngjitni në ndonjë vend të dukshëm në klasë. Potencioni se klasa do të diskutojë në mënyrë të argumentuar dhe pastaj do të rishqyrtohet diskutimi i argumentuar.

Hapi i dytë: Tekst (copë leximi)

Secilit nxënës ndajani nga një kopje të **teksit**. Le ta lexojnë me kujdes dhe le t'i nënvizojnë faktet dhe idetë për të cilat mendojnë se janë të rëndësishme dhe/ose interesante (**më së miri është të jepet si detyrë shtëpie**).

Hapi i tretë: Grupimi dhe diskutimi lidhur me tekstin

Ndajeni klasën në grupe me nga katër ose pesë nxënës. Anëtarët e grupeve duhet t'i ndajnë mes vete faktet e rëndësishme dhe idetë interesante për zhvillim të të kuptuarit të përbashkët të tekstit. Ata mund t'i vërejnë këta fakte dhe ide të **materialit nr. 2 – Aktivitete për diskutim të argumentuar** (shqyrtojeni tekstin)

Hapi i katërt: Përfshirja e çështjes për diskutim të argumentuar

Çdo **tekst** paraqet pyetje për diskutim të argumentuar. Lexojeni me zë dhe/ose ngjiteni ndokund çështjen për diskutim të argumentuar dhe kërkoni nga nxënësit ta shënojnë çështjen në hapësirën e përcaktuar për të brenda **materialit nr. 2**. Përkujtoni nxënësit për rregullat e diskutimit të argumentuar të **materialit nr. 1**.

Hapi i pestë: Zbulimi i shkaqeve

Ndajeni secilin grup në dy ekipe, ekipi A dhe ekipi B. Shpjegojuni që secili ekip duhet t'i dallojë shkaqet më bindëse për qëndrimin e tyre, të cilin ju do t'ua përcaktoni. Të dy ekipet përsëri do të duhet ta lexojnë **tekstin**. Ekipi A do t'i gjejë shkaqet më bindëse për ta përmbajtur çështjen për diskutim të argumentuar, ndërsa ekipi B do t'i gjejë shkaqet më bindëse për ta **kundërshtuar** çështjen e diskutimit të argumentuar. Për të mundësuar pjesëmarrje maksimale, kërkoni nga ekipi që së paku të përgatitet ta prezantojë një arsye.

Vërejtje: Ekipi A dhe B nuk komunikojnë mes vete derisa t'i gjejnë shkaqet. Nëse nxënësit kanë nevojë për ndihmë gjatë dallimit të argumenteve ose nëse koha është e kufizuar, atëherë shfrytëzoni materialet të cilat përmbajnë **çështje për diskutim të argumentuar**. Kërkoni nga nxënësit t'i dallojnë (përcaktojnë) argumentet më të fuqishme si dhe shtoni argumente plotësuese, të cilat do t'iu kujtohen nxënësve pasi ta lexojnë tekstin.

Hapi i gjashtë: Prezantimi i shkaqeve më bindëse

Tregojuni nxënësve që secili ekip do t'i prezantojë shkaqet më bindëse për **mbështetjen** ose për **kundërshtimin** e çështjes për diskutim të argumentuar. Gjatë përgatitjes së hapit vijues, ndryshoni këndvështrimet, secili ekip le të dëgjojë me vëmendje që t'i mbajë mend shkaqet më bindëse.

- Ekipi A do t'i shpjegojë shkaqet se pse e **mbështesin** çështjen për diskutim të argumentuar. Nëse ekipi B nuk ka kuptuar diçka, anëtarët e tij do të duhet të parashtrajnë pyetje, por NUK duhet të grinden me fjalë.
- Ekipi B do t'i shpjegojë shkaqet e veta lidhur me **kundërshtimin** e çështjes për diskutim të argumentuar. Nëse ekipi A nuk ka kuptuar diçka, anëtarët e tij do të duhet të parashtrajnë pyetje, por gjithashtu NUK duhet të grinden me fjalë.

Vërejtje: Ekipet mund të mos kenë besim në çështjet të cilat duhet t'i mbështesin ose kundërshtojnë, ose fare mund të mos pajtohen me to, por megjithatë duhet të jenë sa më bindës gjatë prezantimit të tyre para nxënësve tjerë.

Hapi i shtatë: Ndryshim i këndvështrimeve

Shpjegojuni që me qëllim që të dy palët t'i kuptojnë argumentet e kundërta, secili ekip do t'i zgjedh shkaqet më bindëse të ekipit tjetër.

- Ekipi B do t'i shpjegojë ekipit A se cilat janë shkaqet më **bindëse** të ekipit A për **mbështetjen** e çështjes së diskutimit të argumentuar.
- Ekipi A do t'i shpjegojë ekipit B se cilat janë shkaqet më **bindëse** të ekipit B për **kundërshtim** të çështjes së diskutimit të argumentuar

Hapi i tetë: Diskutim i argumentuar lidhur me çështjen

Shpjegojuni se tani nxënësit do t'i lënë anash rolet e tyre dhe do të diskutojnë në mënyrë të argumentuar për çështjen në nivel të grupit. Përkujtojani klasës se për cilën çështje bëhet fjalë. Gjatë diskutimit të argumentuar nxënësit mund (1) ta shfrytëzojnë atë që e kanë mësuar lidhur me çështjen dhe (2) të ofrojnë përvoja të tyre personale në formulimin e mendimeve lidhur me atë çështje.

Pas diskutimit të argumentuar, nxënësit le të gjejnë sfera të pajtueshmërisë në grupet e tyre. Pastaj kërkoni nga nxënësit, personalisht para grupit ta shprehin qëndrimin tyre personal lidhur me çështjen si dhe ta shënojnë atë (shikojeni pjesën e **materialit nr. 2** të ashtuquajtur Qëndrimi im personal).

Vërejtje: NUK është patjetër që disa nxënës të pajtohen me qëndrimin e grupit.

Hapi i nëntë: Vështrim ndaj diskutimit të argumentuar

Tubojeni tërë klasën. Ndajeni **materialin nr. 3 – Vështrim ndaj diskutimit të argumentuar për nxënës** i cili do t'u shërbejë si udhëzues. Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë për këta çështje:

- Cilat ishin shkaqet më bindëse për secilën palë?
- Në cilat sferat hasnin në pajtueshmëri?
- Cilat çështje ende ju kanë ngelë? Ku mund të gjeni më shumë informacione?

- Numëroni disa arsye lidhur me këtë çështje se pse është i rëndësishëm diskutimi i argumentuar në shoqëri demokratike?
- Çka do të mund të bëje ti ose klasa yte që të ballafaqoheshit me këtë problem? Mundësitë përfshijnë mësim të tjerëve për gjërat që i kanë mësuar; shkrim të letrave deri te personat e zgjedhur qeveritar, organizatat joqeveritare ose kompanitë si dhe realizim të hulumtimit plotësues.

Mendoni lidhur me mundësinë që nxënësit të përgatisin vështrime personale lidhur me çështjen e diskutimit të argumentuar përmes punimeve të shkruara, vizuale ose audio. Opinionet personale mund të prezantohen në internet.

Hapi i dhjetë: Anketë / vështrim për nxënësit

Pyetni: “A pajtoheni, a po nuk pajtoheni ose ende nuk keni vendosur lidhur me çështjen për diskutim të argumentuar?” Shënoni përgjigjet dhe kërkon nga ndonjë nxënës t’i vë rezultatet në www.deliberating.org në pjesën e Partneritetit (partnerships) dhe/ose Anketa (polls). Nxënësit le ta plotësojnë **materialin nr. 3**.



Materiali nr. 1 – Udhëzues për diskutime të argumentuara

Çka është diskutimi i argumentuar?

Diskutim i argumentuar (diskutimi kuptimplotë) është shkëmbim i drejtuar i ideve dhe analizë të argumenteve i cili realizohet me qëllim që të merret vendim.

Pse diskutojmë në mënyrë të argumentuar?

Qytetarët patjetër duhet të dinë mënyrën dhe të duan t'i shprehin dhe shkëmbejnë idetë mes vete, me udhëheqësit e bashkësive dhe me përfaqësuesit e tyre në pushtet. Në demokraci, qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre u nevojiten shkathtësi dhe mundësi për përfshirje në diskutime qytetare dhe publike lidhur me çështje kundërthënëse me qëllim që të sillen vendime për të cilat është informuar publiku i gjerë.

Diskutimi i argumentuar kërkon horizonte të gjera për shkak se kjo shkathtësi i aftëson qytetarët përsëri ta shqyrtojnë një vendim në bazë të informacioneve të reja ose kushteve të ndryshuara.

Cilat janë rregullat e diskutimit të argumentuar?

- Lexojeni me vëmendje materialin e argumentuar.
- Koncentrohuni në çështjen për diskutim të argumentuar.
- Dëgjoni me vëmendje se çka thonë të tjerët.
- Kontrolloni se a i kuptoni gjërat ashtu siç duhet.
- Analizojeni atë që e flasin të tjerët.
- Flisni dhe inkurajoni të tjerët të flasin.
- Referohuni në tekstin më qëllim që t'i mbështetni idetë tuaja.
- Logjikisht shfrytëzoni diturinë relevante paraprake, duke përfshirë përvoja nga jeta e përditshme.
- Shfrytëzoni zëmrën dhe mendjen që të shprehni ide dhe mendime.
- Kur të ballafaqohen qëndrimet, bëhuni të kujdesshëm dhe shprehni respekt ndaj të tjerëve.
- Koncentrohuni në idetë, e jo në personat.



Materiali nr. 2 – Aktivitete për diskutime të argumentuara

Lexojeni tekstin

Përcaktoni faktet më të rëndësishme dhe/ose idetë e rëndësishme dhe shënoni më poshtë.

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

Çështje për diskutim të argumentuar

Zbuloni arsyet

Shkaqet për mbështetje të diskutimit të argumentuar (Ekipi A)	Shkaqet për kundërshtim të çështjes për diskutim të argumentuar (Ekipi B)

Qëndrimi im personal

Në një fletë të veçantë shënoni shkaqet për ta mbështetur mendimin tuaj. Mund të propozoni mënyrë të re të veprimt, që dallon nga metoda e propozuar në çështjen ose të shtoni ide tuaja personale që të merreni problemin.



Emri: _____
Data: _____
Arsimtari: _____

Materiali nr. 3 – Vështrim ndaj diskutimit të argumentuar për nxënës

Diskutim në grup të madh: Çka mësuam

Cilat ishin shkaqet më bindëse të secilës palë?

Pala A:

Pala B:

Cilat ishin sferat e pajtueshmërisë?


Cilat çështje ende ju kanë ngelë? Ku mund të gjeni më shumë informacione?

Numëroni disa arsye lidhur me këtë çështje se pse është i rëndësishëm diskutimi i argumentuar në shoqëri demokratike

Çka do të mund të bësh t'i ose klasa yte që të merresh me këtë problem?

Vështirmi individual: Çka mësova

Cili numër më së miri e shpjegon të kuptuarit tënd për çështjen qendrore? [rrethojeni një numër]



Çka mësova të re?

Çka të shkoi për dore gjatë diskutimit të gjatë diskutimit të argumentuar? Në cilin aspekt duhet të punosh më tepër që t'i përmirësosh shkathtësitë tuaja personale për diskutim të argumentuar?

Cili veprim ose cila fjalë e anëtarëve tjerë të grupit tënd kishte rëndësi veçanërisht të madhe? A ekziston ndonjë aspekt në të cilin grupi duhet të punojë për ta përmirësuar diskutimin e argumentuar grupor

